



REPUBLIKA E KOSOVËS  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO  
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:040045

Datë: 26.09.2024

Numri i dokumentit: 06211046

**C-IV.-13-1988**

*Ankuesi*

M Ç, Prizren.  
Përfaqësuar nga av. Sh R, Prizren.

*Kundër*

*Pala kundërshtare*

N.SH “FAMIPA,, (në likuidim), e përfaqësuar nga  
Agjencia Kosovare e Privatizimit,(AKP) Rr. “Driton Hoxha”, nr. 55, Lakrishtë, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtaren Ganimete Puka, më 26.shtator. 2024, lëshon këtë:

**A K T G J Y K I M**

- I. APROVOHET** pjesërisht si e bazuar kërkesa/ ankesa e ankuesit dhe ndryshohet Vendimi i Agjencisë Kosovare të Privatizimit – Autoriteti i Likuidimit, nr. PRZ024-0109, i datës 26.gusht.2013.
- II. OBLIGOHET** AKP– Autoriteti i Likuidimit të N.SH-së në likuidim, që në emër të dëmshpërblimi për ndërprerje të parakohshme të kontratë së punës, t’ia paguaj ankuesit M Ç, shumën prej 619.5 €, ndërsa pjesa tjetër e kërkesës përtej shumës së aprovuar, refuzohet si e pa bazuar.
- III. OBLIGOHET** Autoriteti i Likuidimit që ankuesit, në emër të taksës gjyqësore, t’ia paguaj shumë prej 20.00€, si dhe përfaqësuesit të ankuesit, në emër të përpilimit të kërkesës/ankesës, t’ia paguaj në shumë prej 104.00 €, gjersa pjesa tjetër refuzohet.
- IV. Shuma** e aprovuar si në pikën II dhe III,të dispozitivit do të përmbushet në pajtim të prioritetit sipas kategorisë së përcaktuar të kërkesave dhe interesave në procedurën e likuidimit.

## **Rrethanat faktike dhe procedurale**

Me 02.tetor.2013, ankuesi përmes të autorizuarit të tij, dorëzoi në Dhomën e Posaçme, ankesë kundër Vendimit nr. PRZ024-0109, i datës 26.gusht.2013, të Autoritetit të Likuidimit (tutje AL) më të cilin ka kërkuar dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës në shumë prej 1.680.00 € ( 19 paga x 88.5 € ), nga N.SH “FAMIPA” (në likuidim). Ankuesi e kundërshton vendimin e AL dhe thekson se kërkesa e tij ka të bëjë me kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nga N.SH. Ka theksuar se ai ka qenë punëtor në N.SH “FAMIPA” nga viti 1972, deri sa atij i është ndërprerë marrëdhënia e punës për shkak të privatizimit me 16.shtator.2011. Tutje, Ankuesi ka pohuar së ishte i regjistruar në listën e të punësuarve dhe me vendimin e kundërshtuar atij , ju kanë shkelur të drejtat e tij ligjore nga marrëdhënie e punës dhe ndihet i diskriminuar për të realizuar një të drejtë të tillë në raport me të punësuarit të tjerë. Ankuesi pohon së me kohe i është drejtuar AL dhe një kërkesë e tillë, ju është refuzuar nga AL, pa kurrfarë baze ligjore. Ankuesi bazën e kërkesës së tij e mbështet në nenin 40.1.6.2 të shtojcës së Ligjit të AKP/së, nr.04/L-034. I propozon Gjykatës, që ankesën e tij ta aprovoj në tërësi si të bazuar.

Me 01.shkurt.2017, e paditura AKP-ja parashtrroi mbrojtje në ankesë ku pohoi së i kundërshton të gjitha pretendimet e ankuesit të paraqitura në ankesë duke i konsideruar si të pa bazuara në ligj dhe si të tilla duhet të refuzohet. E paditura pohoi se ankuesi nuk ka treguar se cili nen i Ligjit 04/L-034 është shkelur nga AL në marrjen e vendimit. Tutje AKP, pohon se ankuesi nuk ka parashtruar ndonjë argument se cila dispozitë e Ligjit për AKP është aplikuar gabimisht nga ana e AL. AKP gjithashtu pohon se punonjësve ju takon e drejta për dëmshpërblim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse janë pushuar nga puna si rrjedhojë e një veprimi të ndërmarr nga Agjencia., ashtu që ankuesi nuk figuron listë e pagave për 6 muajt e fundit, dhe një e drejt e tillë komfor nenin 40.1.6.2 të shtojcës së Ligjit 04/L-034, të AKP/së, nuk i takon. AKP nga të gjitha arsyet propozoj që ankesa të hedhet si e papranueshme ose refuzohet si e pabazuar dhe Vendimi i AL të vërtetohet. AKP, si provë ka dorëzuar listat e pagave të papaguar të punëtorëve dt.19.09.2011.

Me 14 shkurt.2014, ankuesi ka parashtruar përgjigje ndaj mbrojtjes së AKP-së, duke kundërshtuar pohimet e AKP , dhe mbetet në tërësi pranë pretendimeve të parashtruara në kërkesë / ankesë dhe i propozon gjykatës që ta aprovoj kërkesën / ankesën si të bazuar . Ankuesi përgjigjes ia ka bashkangjitur si provë vendimin e kundërshtuar të AL, nr.PRZ024-01029,dt.26.08.2013, librezën e punës, njoftimin dt 16.shtator.2011, si dhe një vendim të dt 03.10.1995.

Me 27.shkurt.2017, AKP ka parashtruar kundërpërgjigje ndaj përgjigjes së parashtruesit/ankuesit duke propozuar që të refuzohet ankesa si e pabazuar në pajtim me nenin 7 të LPK, dhe nenit 23, të shtojcës së Ligjit nr. 04/L-033 dhe të vërtetohet vendimin e AL .

Në lidhje me detajet tjera, gjykata i referohet shkresave të lëndës dhe parashtrësive të palëve.

## **Arsyetimi ligjor:**

### **Ankesa aprovohet pjesërisht si e bazuar.**

Në bazë të nenit 2.4 dhe nenit 77.1.1.1 të Ligjit Nr.06-L-086 të Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (në tekstin e mëtejshëm Ligji për Dhomën e Posaçme), gjykata zbaton dispozitat procedurale të këtij ligji.

Në bazë të nenit 76.3 të Ligjit mbi Dhomën e Posaçme, në lidhje me nenin 398 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, gjykata vlerëson se faktet që përmban ankesa e vërtetojnë atë dhe merr Aktgjykim pa caktuar seancë dëgjimore.

Neni 42 pika 2 e Ligjit për Dhomën e Posaçme, parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka barrën e dëshmisë për të dëshmuar vërtetësinë e pretendimit të tillë, duke paraqitur parashtrësat apo duke paraqitur provat materiale (të dokumentuara, fizike dhe/ose dëshmuese), ndërsa, pika 3 parasheh se pala që pretendon një fakt apo ngjarje ka mundësinë e arsyeshme për të paraqitur apo dorëzuar provat materiale për të mbështetur një pretendim të tillë, nëse pala e tillë dështon që të paraqesë apo dorëzojë provat e tilla, atëherë vlerësohet se pala nuk ka ofruar barrën e dëshmisë lidhur me pretendimin e tillë.

Sipas nenit 7 të Ligjit për Procedurën Kontestimore, palët kanë për detyrë ti paraqesin të gjitha faktet mbi të cilat i mbështesin kërkesat e veta dhe të propozojnë prova me të cilat konstatohen faktet e tilla. Me fjalë të tjera, kushdo që thotë diçka duhet ta dëshmojë atë (*ei incumbit probatio qui dicit*).

Sipas nenit 40.1.6.2 të shtojcës së Ligjit për AKP, punëtorëve u takon e drejta e dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës nëse të njëjtit pushohen nga puna si rrjedhojë e vendimit për likuidim të ndërmarrjes, apo në lidhje me veprimin e ndërmarrë nga AKP, sipas nenit 6.1 apo 6.2 të Ligjit për AKP.

Neni 76.7 i Ligjit të Punës nr. 03-L-212 (si ligj në fuqi në kohën e ndërprerjes së marrëdhënies së punës) thotë që: *Kompensimi i menjëhershëm në para, u paguhet të punësuarve me kontratë me periudhë të pacaktuar në ditën e ndërprerjes së kontratës, sipas kësaj shkalle:*

- 7.1. nga dy (2) deri në katër (4) vite të shërbimit, një (1) pagë mujore;
- 7.2. nga pesë (5) deri në nëntë (9) vite të shërbimit, dy (2) paga mujore;
- 7.3. nga dhjetë (10) deri në nëntëmbëdhjetë (19) vite të shërbimit, tri (3) paga mujore;
- 7.4. nga njëzet (20) deri në njëzetënjë (29) vite të shërbimit, gjashtë (6) paga mujore;
- 7.5. nga tridhjetë (30) vite të shërbimit ose më shumë, shtatë (7) paga mujore;

Gjykata vlerëson se nuk është kontestuese në mes palëve fakti se ankuesi kishte të themeluar marrëdhënie pune dhe ishte një punëtor i NSH "FAMIPA". Në këtë çështje, kontestuese, ndërmjet palëve është fakti se a ka qenë ankuesi punëtor i NSH në momentin e privatizimit të saj. Ankuesi pretendon se ka qenë punëtor i NSH-së, deri sa ndërmarrja ka shkuar në privatizim me datë 16 shtator 2011.

Ankuesi, bazën e kërkesës e mbështet në Njoftimin e datës 16 shtator 2011 për hyrjen e NSH-së në likuidim, librezën e punës, si dhe në pohimet e tij të parashtruara në ankesë. Nga librezat e

punës e dorëzuar si provë, vërtetohet fakti se ankuesi kishte të krijuar marrëdhënie pune nga viti 1972, deri në 2011 (me privatizimin e ndërmarrjes në fjalë).

Andaj, gjykata i pranon si prova relevante librezën e punës, njoftimin e datës 16 shtator 2011 si dhe pohimet e tij të parashtruara në ankesë, për vërtetimin e faktit se ankuesi ka qenë punëtor i NSH-së, në kohën e privatizimit të saj, përderisa e paditura nuk ka mundur të dëshmojë të kundërtën dhe nuk ka dorëzuar ndonjë provë për të vërtetuar faktin se ankuesit ia kishte ndërprerë marrëdhënien e punës me ndonjë vendim apo akt tjetër, para kohës së privatizimit të NSH-së.

Me rastin e aprovimit të shumës prej 619.5 €, në emër të dëmshpërblimit për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, AKP, asnjëherë nuk e ka kundërshtuar shumën e kërkuar nga ankuesi prej 1.680.00€, mirëpo gjykata duke ju referuara provave në shkresat e lëndës me konkretisht Librezës së punës, ka gjetë së ankuesi kishte mbi 30 vite përvojë të punës, dhe bazuar në dispozita ligjore , të lartcekura , *ankuesit i takon një kompensim për 30 vite përvojë pune , prej 7 pagave (7 paga x 88.5 = 619.5€), e jo siç pretendon ankuesi 19 paga , dhe mbi këtë bazë, u vendosë, si në dispozitiv të këtij aktgjykimit.*

Gjykata ka vlerësuar edhe pretendimet e tjera dhe kundërshtimet e palës së paditur në lidhje me objektin e kontestit, por të njëjtat nuk kanë ndikuar për të vendosur ndryshe në këtë çështje. Gjykata vlerëson se e paditura nuk ka mundur të dëshmojë faktin se ankuesi nuk e ka pasur statusin e punëtorit të NSH dhe faktin se me cilën bazë ligjore e ka bërë ndarjen e punëtorëve aktiv dhe pasiv, pasi që asnjë dispozitë ligjore e zbatueshme në Republikën e Kosovës nuk e parasheh këtë ndarje. Ligji i Punës i cili është në fuqi nga viti 2010, parasheh, mënyrën e themelimit të marrëdhënies së punës, përfundimin e një marrëdhënie të punës dhe të drejtat dhe detyrimet e punëtorëve që janë në marrëdhënie pune te një punëdhënës i caktuar.

Nga provat e lartcekura, përkatësisht nga librezat e punës shihet që ankuesi kishte themeluar marrëdhënie pune me NSH deri në kohën e privatizimit të saj, ndërsa e paditura nuk ka dëshmuar se me ndonjë akt të ligjshëm ia kishte ndërprerë ankuesit marrëdhënien e punës para kohës së privatizimit. Po ashtu gjykata vlerëson se ankuesi ka mundur që mos të pranojë pagë dhe të mos jetë në listën e pagave në muajt e fundit para privatizimit, por kjo nuk do të thotë se ai e ka humbur statusin e të punësuarit në NSH.

Mbi të gjitha, ankuesi e bindi gjykatën së ishte punëtor i NSH, deri sa ndërmarrje ka hy në likuidim, dhe ky fakt vërtetohet edhe me listën e pagave të papaguar të dorëzuar nga vetë e paditura, ku ankuesi evidentohet me numër rendor 7, liste e cila është e përpiluar, vulosur dhe nënshkruar nga personi përgjegjës i NSH.

Nisur nga kjo gjendje, gjykata nxjerr përfundim se ankuesi ishte një punëtor i NSH në kohën e privatizimit të saj dhe kësaj i takon e drejta në kompensim për ndërprerje të parakohshme të kontratës së punës, në shumën e aprovuar. Një interpretim i tillë është në pajtim edhe me precedentët e fundit të DHPGJS-së dhe Kolegjit të Apelit (AC-I-21-0041, AC-I-21-0039, etj.).

Andaj në bazë të të lartcekurave dhe në pajtim me nenet 54.1 dhe 74.4 të Ligjit për Dhomën e Posaçme u vendos si në dispozitiv të aktgjykimit.

### **Shpenzimet gjyqësore**

Ankuesi ka paguar taksat gjyqësore.

Kërkesa mbi kompensimin e taksave gjyqësore, për ankuesin, si në pikën III (tre) të dispozitivit u vendos në pajtim me nenin 62 të Ligjit për DHPGJS.

Bazuar në nenin 6.2 lidhur me nenin 6.1 të Rregullores për tarifën e avokatëve, datë 18 mars 2017, vendosi si në pikën IV (katër) të dispozitivit të këtij Aktgjykimi. Shuma e mbetur prej 104.00 Euro, refuzohet si e pa bazuar.

Andaj u vendos si në dispozitiv.

### **Këshilla juridike**

Kundër këtij aktgjykimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditëve nga pranimi i këtij aktgjykimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9.6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

Ganimete Puka,

---

**G j y q t a r e**